





01-1228

	<p style="text-align: center;">Republika e Kosovës Republika Kosova – Republic of Kosovo</p> <p style="text-align: center;">Komuna e Prishtinës Opština Priština – Municipality of Prishtina</p>	<p style="text-align: center;">PRISHTINA</p> 
---	--	--

Në bazë të nenit 21, 22 dhe 44 të Ligjit Nr. 05/L-031 për Procedurën e Përgjithshme Administrative (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 20/21 qershor 2016), nenit 27 dhe 28 të Ligjit Nr. 04/L-110 për Ndërtim (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës nr. 18/03 korrik 2012), nenit 17 pika “d” e Ligjit për Vetëqeverisjen Lokale Nr. 03/L-040 dt. 20.02.2008 nenit 15 pika “d” e Statutit të Komunës së Prishtinës Nr.110-391 dt. 25.02.2010, dispozitave të nenit 12 të Udhëzimit Administrativ nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit, dhe duke vendosur sipas kërkesës 05 Nr. 391/02-121981/20 dt. 17.07.2020, të investitorit Arsim Glooku nga Prishtina, për lëshimin e certifikatës së përdorimit, për ndërtimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm me destinim afarizëm-punëtori për përpunimin e metalit me etazhitet P+0, në Prishtinë, Drejtoria e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, në procedurë administrative, me datën 12.04.2021 lëshon këtë:

CERTIFIKATË E PËRDORIMIT

I. I LËSHOHET Certifikata e përdorimit investitorit Arsim Glloku për përdorimin e ndërtesës me karakter të përkohshëm me destinim afarizëm-punëtori për përpunimin e metalit, me etazhitet P+0, në kuadër të Planit Rregullues “Zona Ekonomike” sipas kërkesës 05 Nr.391/02-121981/20 dt. 17.07.2020, e ndërtuar në kuadër të parcelës kadastrale 508-6, Zona Kadastrale Prishtinë, e ndërtuar sipas Vendimit 05Nr.351-313692 dt. 06.03.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës.

II. Ndërtesa, mund të përdoren, sipas destinimit të përcaktuar në pikën I. të Vendimit të Lejes Ndërtimore 05Nr. 351-313692 dt. 06.03.2017, dokumentacionit ndërtimor dhe Raportit të Inspektimit Final, nga Inspekcioni i Ndërtimit i Komunës së Prishtinës.

III. Ndërtesa mund të përdoren nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certifikate.

IV. Kjo Certifikatë shërben për regjistrimin e ndërtesës në regjistrin kadastral të përshkruar në pikën I. të këtij vendimi.

V. Pjesë përbërëse e këtij vendimi të certifikatës së përdorimit është dokumentacioni sipas shtojca 6 e Udhëzimit Administrativ MMPH. Nr. 05/2017 për mbikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit.

A r s y e t i m

Pronari/investitori Arsim Glloku nga Prishtina, më kërkesën me 05 Nr. 391/02-121981/20 dt. 17.07.2020, i është drejtuar kësaj Drejtorie, për lëshimin e certifikatës së përdorimit të ndërtesës me karakter të përkohshëm me destinim afarizëm-punëtori për përpunimin e metalit, me etazhitet P+0, në lokacionin e përshkruar si në pikën I. të dispozitivit të kësaj certifikate.

Faqe 1 prej 3

Komuna e Prishtinës
Drejtoria e Urbanizmit
Adresa: rr. “Radovan Zogoviq” nr. 1, 10000, Prishtinë-Kosovë
Telefon: + 383 (0) 38 221 242

e-mail: urbanizmi@prishtine.gov.net

Nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i ndërtimit i Komunës së Prishtinës përmes shkresës zyrtare "Akt Përcjellës me referencë 09Nr. 391/02-64529/20 dt. 18.01.2021, ka përcjellë në Drejtorinë e Urbanizmit, Raportin e Inspektimit final të punëve dhe përshkrimit të dokumentacionit, hartuar nga ekipi profesional i Drejtorisë së Inspektionit të Komunës së Prishtinës.

Me kërkesë, investitori ka prezantuar:

- Dokumentacionin sipas Shtojca 5 e udhëzimit administrativ MMPH Nr. 05/2017 për bikëqyrje inspektuese dhe procedurën për lëshimin e certifikatës së përdorimit: Lista kontrolluese e Protokollit të Inspektimit shtojca 2 dhe 4/a deri 4/f
- Vendimin nr. 05 Nr.351-313692 dt. 06.03.2017 për lejimin e ndërtimit të ndërtesës me karakter të përkohshëm me destinim afarizëm-punëtori për përpunimin e metalit, me etazhitet P+0, e ndërtuar në kuadër parcelës kadastrale 508-6, Zona Kadastrale Prishtinë.
- Dispozita urbanistike e objektit me parcelën kadastrale në sistemin Kosovaref01.
- Aktvendimin numër 05Nr. 351-313692 dt. 27.02.2017, mbi caktimin e taksës Administrative për lejen e ndërtimit dhe tarifën për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Dëshmi mbi pagesën e taksës administrative për leje të ndërtimit dhe tarifa për ndikimet nga rritja e densitetit të infrastrukturës.
- Raportin e mbikëqyrjes profesionale për secilën nga fazat e projektit si dhe raportin e udhëheqësit të punishtes, Hysni Morina, IDN. udhëheqës i vend ndërtimit, Yllka Rraci, MSc. mbikëqyrës për arkitekturë, Besart Avdyli, IND. mbikëqyrës për Strukturë, Jeton Canhasi, IDH. mbikëqyrës për Hidro-Instalime, Besim Abrashi, IDE. Mbikëqyrës për Instalime elektrike. Kreshnik Morina, gjeodet.
- Incizimin gjeodezik të objektit, dhe rregullimit të jashtëm-gjendjen e realizuar, me vijën rregullative dhe vijën ndërtimore e vendosur në sistemin koordinativ sipas Kosovaref 01,
- Protokollat e miratuara për të gjitha fazat e ndërtimit,
- Atestet e materialeve dhe rezultatet e testimeve,
- Fotografi gjatë procesit të ndërtimit,
- Fletë pagesat për pagesën e kompensimit,
- Kopjet e diplomave të inxhinierëve mbikëqyrës të objektit,

Drejtorja e Urbanizmit e Komunës së Prishtinës, pas shqyrtimit të kërkesës, provave të lëndës, konkretisht Raportin e Komisionit të Inspektimit Final të Inspektionit të ndërtimit të ndërtesës dhe pas dorëzimit të dokumentacionit nga ana e investitorit, përmes kërkesës 05 Nr. 391/02-121981/20 dt. 17.07.2021 ka konstatuar se:

Në raportet përfundimtare të inxhinierëve mbikëqyrës fazave të ndërtesës: arkitekturë, strukturë, instalimet e ujësjellësit dhe kanalizimit, instalimet elektrike, mbrojtjes nga zjarri dhe punëve zeytare si dhe matjeve gjeodezike, konstatohet se ndërtesa është realizuar në përputhshmëri të plotë me Ligjin e Ndërtimit Nr. 04/L-110, projektin kryesor, Lejen ndërtimore 05 Nr. 351-313692 dt. 06.03.2017. Po ashtu theksohet se punët janë zhvilluar në harmoni me projektin kryesor, si dhe me normat dhe standardet në fuqi, gjegjësisht ndërtesa shumë banesore me afarizëm, mund të përdoret.

Në Raportin e Inspektimit final të lëshuar nga Drejtoria e Inspektionit-Sektori i Ndërtimit, është konstatuar se të gjitha punimet në objekt janë të përfunduara. Po ashtu edhe kërkesat që dalin nga Ligji për Ndërtim Nr.04/L-110, neni 27 janë të aprovuara nga ana e Inspektionit të Ndërtimit.

Kërkesat e Vendimit Lejes Ndërtimore janë zbatuar,

Të gjitha mbetjet janë larguar nga vendi i ndërtimit dhe janë dërguar në një vend adekuat për deponimin e mbeturinave,

Masat për kursim të energjisë janë zbatuar.

Kjo drejtori, bazuar në raportet e prezantuara dhe konstatimet e lartcekura, vendosi që ndërtesa "ndërtesës me karakter të përkohshëm me destinim afarizëm-punëtori për përpunimin e metalit, me etazhitet P+0, mund të përdoret/shfrytëzohet, gjegjësisht të lëshojë certifikatën e përdorimit për këtë ndërtesë.

Bazuar në konstatimet e më sipërme u vendos si në dispozitiv të kësaj Certificate.

Udhëzimi juridik: Pala e pakënaqur me këtë Certificate, me ankesë mund ti drejtohet kësaj drejtorie brenda afatit prej 30 ditësh, duke llogaritur nga dita e marrjes në dorëzim të kësaj Certificate. Bazuar në vlerësimin nga kjo drejtori, ankesa do të shqyrtohet apo do të përcillet te organi epror – MEA-ja.

I dorëzohet: Kërkuesit/Investitorit, Drejtorisë së Kadastrit, Drejtorisë së Inspeksionit, kësaj drejtorie, Qendrës për shërbim me qytetarë dhe në dosje të lëndës.

**DREJTORIA E URBANIZMIT E KOMUNËS SË PRISHTINËS,
05 NR. 391/02-121981/20 DT. 12.04.2021**

Zyrtari:

Berim Osmanaj

U.D. Udhëheqëse e sektorit

Mimoza Berisha Prestreshi

Drejtori:

Ardian Olluri

